



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

KOMUNIKATË PËR SHTYP – 5 shtator 2006

K.I.R. SHPALL FILLIMIN E RINDËRTIMIT NË PRIZREN; SKENDERAJ DHE PRISHTINË

Procesi i rindërtimit ka filluar në kishat e Shën Nikollës, Prishtinë, Kishën Peshkopale të Shën Gjergjit, Prizren, dhe në Manastirin e Joanikije në Deviç dhe pritet që punët do të kompletohen në dhjetor 2006.

Komisioni do të takohet më vonë këtë javë për të vlerësuar rundin e tretë i cili përfshinë punët e rindërtimit në Vushtrri, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Bellopolë, dhe Prizren dhe pritet që punët të fillojnë në këto vende në fund të shtatorit.

Pas vjedhjes së plumbit nga kulmi nga Kisha e Shën Virgjëreshës Ljeviska në fund të vitit të kaluar, punët për riparimin e kulmit të Kishës tashmë janë kompletuar me sukses. Punët e më tutjeshme do të kryhen në kambanoren e Ljeviska si pjesë e fazës tjetër të rindërtimit.

Shtatori shënon hapjen e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në të cilat Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do të merr pjesë. Është përgatitur një broshurë nga Njësia Teknike e KIR me përkrahjen e Këshillit të Evropës për të informuar publikun mbi punët e Komisionit dhe të rrisë vetëdijen e rehabilitimit të trashëgimisë së përbashkët evropiane.

Puna e vazhdueshme e Komisionit për Implementimin e Rindërtimit është e përkrahur nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, IPVQ-të dhe UNMIK-u dhe i është dhënë përkrahje shtesë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim.



Zyra e Sekretariatit të KiE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62